



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

11767

UDHËZIM

15.6.2022

Nr. 16, Datë 15. 6.2022

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.31, DATË 26.12.2013
“PËR EMETIMIN NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
TË OBLIGACIONEVE NË FORMË REGJISTRIMI” TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe neneve 5 dhe 20 të Ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.31, datë 26.12.2013, “Për emëtimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime si më poshtë:

Neni 1

Pas pikës 4 të nenit 1, shtohet pika 5 me përmbajtje si vijon:

5. Blerja mbrapsht (procedura e riblerjes) është metoda që përdoret për një menaxhim aktiv të portofolit të borxhit publik, me qëllim mitigimin e riskut të rifinancimit dhe përmirësimin e profilit të borxhit të brendshëm.

Neni 2

Pika 1 e nenit 3 ndryshohet si vijon:

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë si përfaqësuese e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në emëtimin e titujve shtetërorë, për çdo tremujor, jo më vonë se 15 ditë para fillimit të tremujorit përkatës, publikon kalendarin e emëtimit të llojeve të ndryshme të obligacioneve. Në këtë kalendar, përcaktohet frekuenca e zhvillimit të ankandeve, datat dhe shumat indikative të emëtimit sipas afateve të maturimit të obligacioneve. Në rastin e riblerjes, përcaktohet:

- a) ISIN që do blihet mbrapsht (riblerje);
- b) Shuma që pritët të blihet parakohe;
- c) Data e ankandit;
- d) Data e shlyerjes

Neni 3

Pas pikës 1 të nenit 5, shtohet pika 1.1 me përmbajtje si vijon:

1/1. Për ankandet e riblerjes, njoftimi përmban elementët e mëposhtme:

- a) Numrin unik (ISIN) të titullit që do blihet mbrapsht;
- b) Shumën që do blihet mbrapsht;
- c) Datën e shlyerjes së ankandit;
- d) Tipin e ankandit (uniformë apo me shumë çmime).

Neni 4

Pas pikës 1 të nenit 12, shtohet pika 1.1 me përmbajtje si vijon:

1/1. Për ankandet e riblerjes, Ministria vendos për nivelin e normës së interesit (yield-it) të pranuar në bazë të të cilit përcaktohen fituesit e ankandit të riblerjes (shitësit e obligacioneve).

Neni 5

Ky udhëzim hyn në fuqi pas Botimit ne Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

Delina IBRAHIMAJ

